



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/98

Datë: 22.05.2026

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008) dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, Kryetari i Komunës së Junikut, me datë 22.05.2026, merr këtë:

V E N D I M

**PËR KAKTIMIN E KOORDINATORIT TË PROCESIT DHE EMËRIMIN E GRUPIT
PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR
KOMUNËN E JUNIKUT PËR VITIN 2025**

I. Me këtë Vendim caktohet Koordinatori i procesit për çështje audituese dhe formohet Grupi Punues (GP) për hartimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Komunën e Junikut për vitin 2025, në këtë përbërje:

1. Arten Hamza, Zyrtar Kryesor Financiar, Koordinator i Procesit dhe Kryesues i Grupit Punues.
2. Ardita Hoxha , Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa, Anëtare.
3. Leonora Shehu, Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme Anëtare.
4. Lindita Shehu, Zyrtare për pasuri Anëtare.
5. Artan Krasniqi, Udhëheqës i Personelit, Anëtar.
6. Saranda Isufaj, Udhëheqëse e Tatimit ne pronë, Anëtare

II. Koordinatori i Procesit dhe GP kanë për detyrë të operojnë në përputhje me Procedurat Standarde të Operimit (PSO) – trajtimi i të gjeturave dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm nga Subjekti i Sektorit Publik (SSP) i audituar, aprovuar nga Ministria e Financave.

III. Ky Vendim hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dorëzohet

- Koordinatorit të procesit
- Anëtarëve të Grupit Punues
- Arkivit.

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu